

KUPONI TATIMOR

Është detyrimi i shitësit, por edhe i blerësit që çdo mall i shitur apo shërbim i kryer, jo nëpërmjet bankës, të shoqërohet me kuponin tatimor, të lëshuar nga pajisja fiskale.

Blerës,

Është detyrimi Juaj të merrni kupon tatimor! Bëhu pjesë e luftës kundër evazionit fiskal.

Kjo do të ndikojë në cilësinë e jetës, duke bërë të mundur që shteti të përmbushë më mirë detyrimet e tij ndaj jush, duke rritur cilësinë në shërbimet publike si:

- politikat sociale, arsim, shërbimet shëndetësore, gjykatat, ndërtime infrastrukturore, shërbimin e ruajtjes së rendit publik, etj.

Duke marrë kuponin tatimor çdo blerës, sigurohet se ka paguar vlerën reale të tregut për mallin e blerë apo shërbimin e përftuar.

Kush nuk merr kuponin tatimor:

Përkeqëson mundësinë e rritjes së nivelit të shërbimeve publike.

Favorizon evazion fiskal dhe kjo është jo më pak se nxitje e mashtrimit.

Nuk zbaton një nga detyrat kryesore të çdo qytetari duke dëmtuar veten, familjen e tij, por dhe të tjerët.

- Blerësi ose përfituesi i shërbimit, i cili gjatë kontrollit rezulton se nuk disponon kupon tatimor për mallrat ose shërbimet e blera, në një distancë jo më shumë se 30 metra nga vendi i daljes së njësisë së shitjes së mallit ose shërbimit, dënohet me një gjobë prej 1.000 lekësh.

Ju jeni të mbrojtur nga ligji:

- Çdo blerësi, i lind e drejta të mos kryejë transaksionin për vlerën e mallit ose shërbimit të ofruar, nëse shitësi nuk lëshon kuponin tatimor. Për këtë qëllim, tatimpaguesi duhet të ketë afishuar për këtë, njoftim për blerësin, në një vend të dukshëm, në vendin e ushtrimit të aktivitetit.

Kush kryen evazion fiskal ndikon në përkeqësimin e shërbimeve publike. Provokon rritjen e detyrimeve, barrës fiskale apo koston e jetës për qytetarët korrektë të cilët plotësojnë detyrimet e tyre.

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ka vënë në dispozicion të qytetarëve numrin e telefonit pa pagesë 0800 14 14, në të cilin ju mund të denonconi çdo rast të evazionit fiskal si dhe në adresën e postës elektronike:

denoncime@tatime.gov.al.

Për më shumë informacion klikoni në www.tatime.gov.al, drejtohuni në sportelet e shërbimit ndaj tatimpaguesve në çdo Drejtori Rajonale Tatimore, ose telefononi në numrin pa pagesë

0800 00 02

të Qendrës së Thirrjeve pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.